

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 09.01.2024*

**09.01.2024
Ora 12:06**

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancën e sotme publike kemi në rend dite: Plotësimin e vakancave në Këshillin e Bashkisë Gramsh, në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, Bashkisë Kurbin si dhe shqyrtim të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues Sokol Abedin Kullolli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Gramsh, Qarku Elbasan, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia e Reformave Demokratike. Gjithashtu dhe për subjektin vetëdeklarues Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për kryetar bashkie në Bashkinë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike.
Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, Gramsh dhe Kurbin kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, nga këshilltarët e tyre. Kandidatët fitues nga listat shumëmemërore të partive përkatëse që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 09.01.2024*

u takon mandati i këshilltarit, kanë plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të këtyre kandidatëve për këshilltarë, rezulton se asnjë prej tyre nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim të ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore për të tre kandidatët ku në përgjigje të kërkesës sonë DPGJC ka kthyer përgjigje ku kandidatët e Këshillit të Bashkisë Gramsh dhe Fushë-Arrëz kanë ndryshuar përbërësit e gjendjes civile pas martesës. Ndërsa DPGJGJ ka dërguar verifikimin e të dhënave ku rezulton se kandidatët nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Mbështetur në pikën 2, Kreu V, të vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë të këshillave të bashkive Gramsh, Fushë-Arrëz dhe Kurbin nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni tre projektvendimet për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Bindja Demokratike, Zonjën Brunilda Ramazan Gjevori.
- Plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zonjën Vjollca Ndoc Tabakaj.
- Plotësimin e vakancës për Këshillin e Bashkisë Kurbin me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Progresiste LZHK, zotin Laurin Fatmir Sana.

Vendimi nr. 01, 02, 03

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 09.01.2024*

09.01.2024
Ora 12:08

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Sokol Abedin Kullolli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Gramsh, Qarku Elbasan, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia e Reformave Demokratike Shqiptare”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës për verifikimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektet vetëdeklarues.

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për anëtar në këshillin e bashkiak”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Sokol Kullolli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Gramsh, më datë 01.04.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 09.01.2024*

KQZ bëri verifikimin paraprak dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të zotit Sokol Kullolli, rezulton se ka deklaruar se është marrë masa e dëbimit nga shteti Hollandez në vitin 2017. Gjithashtu ka deklaruar se ka jetuar në Francë në vitin 2017 dhe në Greqi si emigrant ekonomik për periudhën 2008 dhe 2015-2016. Nisur nga konstatimet e mësipërme dhe referuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit të subjektin Sokol Kullolli”. Në përfundim të kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, konstatohet se subjekti vetëdeklarues Sokol Kullolli, kandidat për anëtar të Këshillit Bashkisë Gramsh, i propozuar nga Partia Reforma Demokratike nuk përfshihet në fushën e veprimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare në Këshillin e Bashkisë Gramsh, ka fituar dy mandate dhe zoti Sokol Kullolli, kandidat i listës shumemërore të kësaj parti, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, për sa u relatua,

- Konstatohet se zoti Sokol Abedin Kullolli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Gramsh, Qarku Elbasan, i propozuar nga Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit të këshillit.

Vendimi nr. 04

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 09.01.2024*

09.01.2024
Ora 12:11

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.


Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, zoti Ferdinand Saraçi, kandidat për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, më datë 8.02.2022, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 10. KQZ bëri verifikimin paraprak dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se kandidati ka deklaruar ndryshime në gjeneralitetet e gjendjes civile si dhe ka deklaruar një vendim penal jashtë Republikës së Shqipërisë, në Itali. Nisur nga konstatimet e mësipërme, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 09.01.2024*

Zgjedhjeve, vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 21.12.2023 vendimin "Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Ferdinand Saraçi". Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme, zoti Ferdinand Saraçi, kandidat për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022, nuk ka marrë mandat dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Për sa kohë që ky subjekt nuk ka përfituar mandat dhe në asnjë rast dhe asnjë rrethanë nuk do të mundet të marrë këtë funksion publik, për të cilin është iniciuar dhe procedura administrative e verifikimit të thelluar, Komisioneri nuk mund të shprehet me vendim. Në rastin objekt shqyrtimi në analizë edhe të nenit 90, 95 të Kodit të Procedurave Administrative, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëherë, për këtë rast vendosim:

- Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Ferdinand Shefqet Saraçi, kandidat për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, 6 mars 2022.

Çështje tjetër nuk kemi?

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi!

Z. I. Celibashi: Mirë, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 05

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

